




PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **23.07.2026**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Fatmir Iska**. Kryesuesi konstatoi se, kuorumi për mbajtjen e mbledhjes ekziston. Në fillim të mbledhjes, nga 27 anëtarë, të pranishëm kanë qenë 25.

Kryesuesi: Përshëndetje për të gjithë! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, të nderuar anëtarë të kuvendit komunal, drejtorë të drejtorive komunale, sekretari e kuvendit, zyrtarë komunalë, përfaqësues të KFOR-it, medije dhe ju të nderuar qytetarë të komunës së Rahovecit. Kjo është mbledhja e shtatë e rregullt dhe në bashkëpunim me kryetarin kemi vendosur për këtë rend dite:

REND DITE



1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljes me interes të përgjithshëm të pjesës së parcelës, P-71510018-00428-2, ZK - Dejnë;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim-plotësimit të Rregullores 01Nr.23 të datës 30.03.2023, për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Rahovecit;
4. Shqyrtimi i raportit financiar gjashtëmujor (6), janar-qershor 2026;
5. Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e planit për mirëmbajtjen e hapësirës publike në komunën e Rahovecit;
6. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2025;
7. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor i punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2026;
8. Shqyrtimi i informatës nga drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, janar – Qershor 2026;
9. Shqyrtimi i raportit të komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;
10. Shqyrtimi i raportit vjetor mbi menaxhimin e pasurive të Komunës së Rahovecit për vitin 2025;
11. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve.

Shtesë: 1. Raporti i DKA-së për fundvitin mësimor 2025-2026.

2. Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të QMF-së në Fortesë.

Kryesusi: Atëherë, fillimisht në nderim të dëshmorëve për Epopenë e Korrikut, ju lus për një minutë heshtje!... Lavdi! Pas leximit të rendit të ditës prej 11 pikave, i kemi edhe dy pika shtesë. 1. Raporti i DKA-së për fundvitin mësimor 2025-2026 dhe 2. Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të QMF-së në Fortesë.

A e keni pranuar materialin me kohë, nëse dikush ka vërejtje? E hapim debatin rreth rendit të ditës.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, kryesues! Te rendi i ditës, materialin për për ndërtimin e objektit të QMF-së në Fortesë nuk e kemi pranuar. E kam gjithashtu një vërejtje për transmetuesin. Në seancën e kaluar i gjithë transmetimi është bërë me pengesa. Kërkoj që ky defekt të mënjanohet, sepse operatori paguhet për këtë punë dhe qytetarët kanë nevojë t'i dëgjojnë kërkesat e tyre.

Kryesuesi: Sa i përket transmetimit me pengesa, unë tani po e marr informatën sinqerisht dhe besoj që kompania do ta rregullojë këtë problem. Sa i përket vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e QMF-së në Fortesë, ia kaloj fjalën drejtorit Afrim.

Afrim Oruqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit. Pas nënshtrimit të memorandumit për ndërtimin e QMF-së në Fortesë dhe pas caktimit të grupit punues për hartimin e detyrave projektuese, njëra prej detyrave që i ka kaluar Komunës së Rahovecit është caktimi i lokacionit, ndarja e parcelës dhe e njëjta parcelë t'i kalon në shfrytëzim drejtorisë së Shëndetësisë. Kjo është arsyeja e vonës për këtë seancë. QMF-ja do të ndërtohet në vendin e njëjtë ku është QMF-ja aktuale. Sot po kërkojmë që ta caktojmë lokacionin, ta ndajmë parcelën dhe të kalojë në shfrytëzim të drejtorisë së Shëndetësisë, duke mos e ndërruar pronarin (Komuna e Rahovecit). Në mënyrë që të mos vonohemi në raport me ministrinë, kërkoj mirëkuptimin tuaj që ky vendin të futet në rend dite dhe të votohet gjatë kësaj seance.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë anëtarë të kuvendit, medie. Dua të lidhem me Lirigzonin, rreth ankesave të transmetimit të seancave. Nuk besoj që mjafton një vërejtje, sepse prej 7 seancave, ndoshta 4 seanca nuk kanë qenë në rregull me transmetim. Përveç vërejtjeve zyrtare, mendoj që ndoshta duhet të vazhdohet edhe me shkëputje të kontratës. Qytetarët kanë nevojë ta shohin atë që bëhet në kuvendin komunal, ta shohin punën e anëtarëve të kuvendit, si dhe votat e kuvendarëve. Nëse kjo nuk është në rregull, atëherë puna jonë 50% është më pak e vlefshme. Te pika shtesë që e prezantoi drejtori, a do të jetë investim i komunës ndërtimi i QMF-së në Fortesë? Dihet që problematikë të kjo QMF në Fortesë ka qenë funksionalizimi i saj. Çka duhet të bëjë drejtoria për ta rregulluar këtë çështje?

Kryetari: Kemi memorandum mirëkuptimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe financimi bëhet nga ata. Objekti ekzistues duhet të rrënohet, sepse është në pikën më të ulët dhe vazhdimisht është vërshtuar nga shiu. Besoj që në projektin e ardhshëm do të bëhet më ndryshe dhe jam i bindur që do të jetë funksionale.

Berat Duraku: Faleminderit, kryesues! Kërkoj që pika e tretë (rregullorja për mbeturina) të zhvendoset më poshtë, sepse ndërkohë duhet të bashkëngjitet me neve edhe kryeshefi ekzekutiv i Ekoregjionit.

Kryesuesi: Faleminderit, Berat! Atëherë, po i vendosi fillimisht në votim pikën shtesë. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Me 23 vota "për", miratohen pikë shtesë për këtë mbledhje të kuvendit.

Defrim Kafexhiu: Dua të them diçka rreth punës së rendit të ditës. Jemi në seancën e shtatë të rregullt dhe pika e fundit "pyetjet dhe përgjigjet", nuk është produktive si pikë e fundit e rendit të ditës. Kërkoj nga ju si kryesues me mirëkuptim dhe vullnet që ta vendosni si pikë të dytë të rendit të ditës, ashtu siç ka qenë në mandatin e kaluar, vetëm për shkak të produktivitetit që e ka si pikë për çështje të rëndësishme për interes të qytetarëve.

Kryesuesi: Faleminderit, Defrim! Do të takohemi me shefat e grupeve në një pauzë dhe do ta diskutojmë për seancën tjetër dhe do të vendosim nëse do të jetë si pikë e dytë. Normalisht që vendoset me fuqinë e votës. Tani po e vendosi rendin e ditës në tërësi, bashkë me propozimin e Berat Durakut. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenime?... Me 22 vota "për" miratohet rendi i ditës.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush diçka rreth procesverbalit, ndonjë vërejtje?... Nëse jo, e vendosim në votim. Kush është “për”?... Me 23 vota “për” miratohet pika e parë.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljes me interes të përgjithshëm të pjesës së parcelës, P-71510018-00428-2, ZK – Dejnë:

Besmire Bytyqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, anëtarë të kuvendit, drejtorë. Në materialin e pranuar nga zyra e kuvendit e keni pranuar edhe shpalljen me interes të përgjithshëm të një pjese të parcelës në zonë kadastrale në Rahovec, parcela me nr. 00956-0, çështje të cilën do ta shqyrtojmë më tutje. Është shpallje me interes të përgjithshëm të pjesës së parcelës 00428-2, ZK Dejnë. Pjesa e përgjithshme e parcelës është 10.459m² dhe nga kjo parcelë, 4500m² është në propozim. Këtu po provojmë që ta bëjmë shpronësimin e kësaj pjese të parcelës, e cila gjendet afër festivalit “Anadrinia Jehon” dhe qëllimi ynë është që ta zgjerojmë hapësirën e festivalit. Hapësira në fjalë të shpronësohet dhe të bëhet e Komunës së Rahovecit.

Lirigzon Kastrati: Vazhdimisht edhe në seancat e kaluara, kemi kërkuar që vendimet për dhënien në shfrytëzim të vendosen në projektor. Drejtoresha, për seancat e radhës të ketë konsideratë. E përkrahim këtë pikë, sepse festivali “Anadrinia Jehon” është festival i rëndësishëm i komunës.

Kryesuesi: Faleminderit, Lirigon! Dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë po e vendosi në votim. Kush është “për”?... Me 22 vota “për” miratohet pika e dytë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i raportit financiar gjashtëmujor (6), janar-qershor 2026:

Afrim Limani: I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë drejtorë dhe ju asambleistë. Konsideroj që raporti është i përgatitur mirë, duke u përfshirë të gjitha ngjarjet financiare që kanë ndodhur në komunën e Rahovecit brenda këtij 6-mujori. Raporti përbëhet nga tri pjesë: pjesa e të hyrave, pjesa e shpenzimit të buxhetit, si dhe nga pjesa e kontratave të lidhura brenda këtij afati. Si rezultat i mungesës së buxhetit, shumë kontrata të planifikuara nuk janë lidhur. Jeni në dijeni që pothuajse në tërësi investimet kapitale janë tërhequra nga thesari, shkaku i kontratës kolektive. Të hyrat brenda kësaj periudha: 913.714€ dhe nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë me vitin e kaluar, kemi ndryshim negativ prej 211.244€. Në raport, gjithashtu janë të përfshiera realizimet e të hyrave ndërvite. Deri në këtë periudhë që po raportoj, bashkë me gjobat e gjykatave dhe të trafikut të tremujorit të parë, sepse të tremujorit të dytë nuk janë alokuar ende, janë në total 1.033.000. Në raport janë të përfshiera edhe inkasimet e të hyrave sipas kategorive ekonomike. Për shkak të problemeve me sistem, nuk janë të plota të hyrat e tatimit në pronë. Në faqen 9 e kemi shpenzimin e buxhetit, që në total deri më tani është 14.356.000 (64.74%). Vlen të ceket që përqindja më e madhe është te investimet kapitale me 77.78% të shpenzimit. Vlera e kontratave të lidhura deri më tani është 763.350€. Në këtë pikë, shumë nga aktivitetet e prokurimit nuk janë lidhur, për shkak të mungesë së buxhetit. Siç e dini edhe ju, thesari i ka marrë pothuajse të gjitha mjetet, për shkak të kontratës kolektive.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Përshëndetje për të gjithë! Te drejtoria e Shëndetësisë, te pjesa e furnizimeve mjekësore e vërejta që për gjashtë muaj, drejtoria i ka shpenzuar rreth 46.000€, e cila nuk është shumë e vogël. Nëse edhe në këto shpenzime përfshihen edhe materialet bazike si: sistemi për infuzion dhe bebi sistemi, të cilat kushtojnë vetëm 20 centë, pse pacientët po detyrohen që në ndërrim të natës të kërkojnë barnatoren më të afërt kujdestare për blerjen e e një sistemi 20 centë. Kam pasur rast personalisht në kujdestarinë e mbajtur, që rreth 10 pacientë janë detyruar që prej QKMF-së të vinë në Lagjen e Epërme vetëm për një sistem apo një bebi sistem.

Jusuf Dërmala: Përshëndetje për të gjithë! Pse realizimi i tatimit në pronë, këtë vit është më i vogël sesa në vitin e kaluar (për 6-mujorin e këtij viti)? Ku qëndron problemi i kësaj?

Lirigzon Kastrati: E kemi analizuar raportin dhe i kemi shqetësimet tona. Së pari, realizimi i të hyrave vetanake është dukshëm nën planifikim. Janë planifikuar 1.125.000 dhe janë realizuar 913.000, rreth 212.000€ më pak. Kjo tregon që komuna nuk po arrin t'i mbledh të hyrat, të cilat i ka planifikuar vet. Së dyti, është shqetësues fakti që

disa kategori të rëndësishme të të hyrave kanë realizim dukshëm më të ulët. Tatimi në pronë është realizuar vetëm 54%, me arsyetimin e drejtorit që është mangësia e gjenerimit në sistem. Diskutimi nuk mund të jetë më produktiv, sepse raporti është i pakompletuar. Së treti, raporti paraqet shpenzim rreth 14.3 milionë euro, ku pjesa më e madhe vazhdon të shkojë në paga dhe mëdijtje, ndërsa investimet kapitale vazhdojnë të mbesin të njëjta dhe kjo tregon që investimet nuk janë në nivelin e nevojave të komunës. Si opozitë, kërkojmë plan konkret për rritjen e inkasimeve të të hyrave nga ana e drejtorisë së Financave.

Sali Sallteku: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Nuk jam ekonomist, por më intereson se a do të vazhdojë të ketë telashe me përmbarues drejtoria e Financave, apo jo?

Defrim Kafexhiu: Te kodi “mallra dhe shërbimet” 13140 “transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendit”. Për këto 7 muaj e kemi parë kryetari që disa herë ka udhëtuar jashtë vendit, ndërsa këtu te shfrytëzimet po e shohim që është zero. Prej cilës kategori janë paguar këto shpenzime, nëse janë paguar prej buxhetit të komunës? Te kodi 13510 “blerja e librave dhe veprave artistike”, gjithashtu edhe këtu janë zero shpenzime. E ftoj ekzekutivin që të paktën ta blejë ndonjë libër! Pse jo, nga një dhuratë edhe për anëtarët e kuvendit!

Afrim Limani: Vlorë, e din që në QKMF ka shpenzime të ndryshme me furnizime mjekësore. Si drejtor, e di që vazhdimisht ka kërkesa aty. Jusufi bëri pyetje rreth dallimit të madh të realizimit të të hyrave në pronë. Është e vërtetë, sepse në tatimin në pronë këtë vit kemi pasur telashe. Faturat për vitin 2026 janë lëshuar në fillim të prillit dhe i bie që 3 muaj nuk kemi pasur fatura, sepse sistemi nuk i ka gjeneruar faturat për vitin 2026. Pikërisht kjo gjendje ka bërë që të ketë mungesë të të hyrave dhe për këtë arsye dallimi me vitin 2025 është 150.000€. Defrim, kryetari ka qenë disa herë jashtë vendit, mirëpo e ka përdorur xhepin e vet dhe për atë shpenzimet janë zero. Duke e parë gjendjen e buxhetit që e kemi, për atë edhe nuk kemi tentuar të blejmë libra. Lirigzon, është e vërtetë që duhet sensibilizim për t’i rritur të hyrat, sepse edhe ju si asambleistë mund të jepni kontribut. Sali, të them të drejtën askush na ne nuk mund ta dijë një informatë të saktë, nëse ka ende lëndë për ekzekutim, apo edhe sa të tilla janë. Në bazë të evidentimit të numrit të mësimeve dhe mjeteve të shpenzuara, konsideroj që mbi 90% e kemi përfunduar.

Lirigzon Kastrati: Drejtor, “transporti për udhëtime zyrtare jashtë vendit” për vitin 2026 te QPS-ja është 770, kurse te Arsimit 34.481€. Çka përfshijnë këto dy kategori?

Afrim Limani: Transporti i udhëtimeve brenda vendit, kryesisht është kontratë për bartjen e nxënësve. Si kod ekonomik regjistrohet ashtu, por është fjala për bartjen e nxënësve.

Lirigzon Kastrati: Në vitin 2025 ka qenë 27.000! A është e njëjta kontratë?

Afrim Limani: Është e njëjta kontratë, mirëpo vitin e kaluar kemi pasur më shumë mjete në dispozicion dhe kemi arritur t’i mbulojmë shpenzimet me kohë. Këtë vit ndoshta jo dhe pikërisht ky është dallimi.

4. Shqyrtimi i informatës mbi implementimin e planit për mirëmbajtjen e hapësirës publike në komunën e Rahovecit:

Përparim Krasniqi: Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të kuvendit, kolegë, monitorues, përfaqësues nga OSBE. Siç e dini, sivjet po ballafaqohemi me një krizë financiare, sidomos në kategorinë “Mallra dhe Shërbime” dhe kemi probleme të obligimeve në vazhdimësi për mirëmbajtjen e hapësirave publike, qoftë për varreza dhe për aktivitete të tjera. Përkundër vështirësive, ne nuk po ndalemi në mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe deponive ilegale, sidomos në prona publike. Informatën e detajuar e kemi para vetes dhe për të gjitha pyetjet do të jem këtu për përgjigje.

Yllka Shehu: Faleminderit, i nderuar kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Raporti flet për mirëmbajtjen e trotuareve, hapësirave publike të gjelbra etj... Në shumë zona, qytetarët ankohen për papastërti. Po e ndërlidhi edhe me ankesën e fundit që e kam bërë rreth mosmirëmbajtjes të varrezave të qytetit. Pyetja ime është se, a ka ndonjë mënyrë inspektive nga drejtoria e Shërbimeve Publike, për të verifikuar nëse shërbimi është duke u kryer nga operatori para procesit të pagesës?

Nehar Shala: Faleminderit, kryesues! Drejtor, i kam dy pyetje: Te larja dhe pastrimi i rrugëve gjatë sezonës verore, thotë se realizohet larja, pastrimi, mirëmbajtja. Pyetja është se kur dhe sa herë gjatë kësaj sezone? Një pyetje tjetër: Në fshatin Nagac është një lis shumë i madh dhe i vjetër. Ka disa muaj që i është thyer njëra prej degëve dhe banorët kanë kërkuar që komuna të kujdeset për këtë gjë, duke mos lënë që ata të rrezikohen.

Lirigzon Kastrati: Për të ofruar shërbime për mirëmbajtjen dhe pastrimin e rrugëve, janë lidhur dy kontrata me vlerë të konsiderueshme, 250.000 me Ekoregjonin dhe 416.000 me Ekodrinia. Në seancën e kaluar ngrita çështjen e mirëmbajtjes së varrezave civile. Dje isha aty dhe qytetarët përsëri po shqetësohet për mosmirëmbajtje. Po ashtu, në fshatin Brestoc, nuk mirëmbahen parqet. Njëjtë edhe në Hoçë të Vogël, por këtu qytetarët me vetiniciativë po detyrohet t'i mirëmbajnë. Varrezat e dëshmorëve gjithashtu duhet të mirëmbahen, jo vetëm gjatë përvjetorëve, por edhe gjatë vitit kalendarik. Një kërkesë tjetër: trotuari Hoçë-Brestoc është projekt i komunës dhe kur pritet të mirëmbahet, sepse po ju sjell vështirësi këmbësorëve.

Përparim Krasniqi: Yllkë, aq sa e di unë, ka mirëmbajtje të rregullt dhe aty ku keni vërejtje, ju lus për bashkëpunim me inspektoratin. Komuna e Rahovecit konsiderohet si një ndër qytetet më të pastërta në nivel vendi dhe këtë gjë nuk po e them unë, por ministria. Larja e rrugëve është një herë në muaj, me gjatësi 1.5km në Krushë të Madhe. Vitin e ardhshëm do ta shqyrtojmë mundësinë që ta rrisim sasinë, sepse 1.5 km në Krushë është pak dhe së paku ta bëjmë 3-4 km. Sa i përket lisit në Nagac, e kemi dërguar ekipin tonë aty, por ajo është pjesë nën mbrojtjen e monumenteve kulturore dhe pa marrë pëlqim prej atyre (institutit), nuk guxojmë të ndërmarrim asnjë veprim. Aq sa kemi informata, për momentin nuk shfaq rrezik për qytetarë. Lirigzon, pastrimi i varrezave është me metra katror dhe pjesa ku po e kërkon ti është jashtë varrezave, por në momentin që e dërgojmë ekipin, do ta pastrojmë edhe atë pjesë. Sa i përket rrugës rajonale edhe për trotuare është përgjegjëse Ministria e Infrastrukturës, e cila kurrë nuk ka ardhur për pastrim dhe mirëmbajtje, ndërsa ne si komunë në bashkëpunim me Ekoregjonin kemi bërë pastrim shumë shpesh.

Fahrije Lushi: Të nderuar kolegë këshilltarë, drejtorë dhe ju të pranishëm. E kam një kërkesë specifike. Festivali "Hardh Fest" është në prag të fillimit. Drejtor, merre për bazë më tepër rrethin në hyrje nga Malisheva dhe rrethin poshtë te Fortesa. Të mirëmbahet më me shumë me gjelbrim, sepse do të kemi shumë vizitorë. Për moment, me këtë gjendje asnjë përshtypje të mirë nuk janë duke e dhënë. Kjo kërkesë e imja pothuajse është e përvitshme.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Dua të ndërlihem me kolegen Fahrijen, e cila e përmendi rrethin në Lagjen e Epërme. Drejtor, kohëve të fundit rrethi është i shkatërruar dhe njëkohësisht i rrezikshëm për banorët dhe për ata që vinë për herë të parë në Rahovec, të cilët e shohin qytetin e shkatërruar, si dhe menjëherë e vërejnë dallimin Malishevë – Rahovec. A keni ndonjë plan për atë rreth?

Defrim Kafexhiu: Drejtor, te rrugët regjionale, mirëmbajtja e të cilave është përgjegjësi e ministrisë, e the që nuk janë pastruar asnjëherë. Do ta pyesja drejtorin, nëse e ka dërguar ndonjëherë në ministri ndonjë kërkesë zyrtare ose të paktën ndonjë ankesë? Ka qytetarë që nuk e dinë se përgjegjësi e kujt është dhe gjithashtu nuk janë në dijeni se kujt t'i drejtohen me ankesa. Përndryshe, në qytet, mirëmbajtja e rrugëve gjatë dy sezonave është për t'u marrë shembull. Nuk ka pasur asnjë problem edhe kur ka ra borë, por edhe gjatë verës po bëhet një punë e jashtëzakonshme, në larjen e rrugëve kryesore dhe në mirëmbajtjen e tyre.

Jusuf Dermalaj: E kam pasur një kërkesë më herët në lidhje me pastrimin në e Hamocit. Drejtor, mirë keni bërë që i keni çu bagerat, por jo t'i mbulosh mbeturinat me dhe, duhet ta pastrosh vendin. Kjo çasje është e gabuar. Pastroje vendin dhe mos i mbulo mbeturinat.

Përparim Krasniqi: Fahrije, në seancën e kaluar e përmenda që ministria nuk po bën pastrim në rrugë rajonale, por po detyroheni ne t'i pastrojmë ato. Ekoregjioni, ndoshta është hera e dhjetë sivjet që po e pastron rrugën për Malishevë. Gjithashtu, edhe pse nuk e kemi në kontratë, Ekoregjioni e mirëmban edhe rrugën për Suharekë. Defrim, dhjetra kërkesa i kemi parashtruar te ministri Liburn Aliu, sidomos për Hoçë të Vogël kur është bërë shembja e murit, por kurrë asnjë vizitë nuk e kanë bërë. Rrethrotullimi në pjesën te "Rrasat": në muajin mars, ka

bërë kërkesë kompania që i ka vendosur turbinat që rrethi të prishet për shkak të bartjes së tyre. Jemi në fazën përfundimtare dhe rrethi do të rikthehet në gjendjen e mëparshme nga kompania në fjalë. Do të vendosen edhe 6 shtylla të ndriçimit publik, si dhe 6-7 drunjtë të dëmtuar, me madhësinë siç kanë qenë. Pas 15 gushtit do të fillojnë punimet në rrugën 4-korsi, rrethi poshtë do të trajtohet dhe të ta ketë një pamje më ndryshe. Jusuf Dërmala pyeti për mbeturina: Jusuf, kanë qenë mbeturina inerte, jo të amvisërisë. Mbeturinat inerte nuk bëjnë dëme dhe lejohen të varrosen. Në momentin që keni bërë kërkesë, kemi bërë veprime të menjëhershme. Ju lus që të lajmëroni vazhdimisht raste të tilla.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Drejtor, meqenëse jemi te ndriçimi publik, nuk e di nëse e din gjendjen rreth qytetit, ku shumë lagje janë pa ndriçim publik. Te lagjia ku banoj unë “Sheshi i Republikës, te pjesa ku banon drejtori i Shëndetësisë, rruga “Mexhid Mustafa”, rruga “Jahja Danuza”, pjesa te furra “Pashtriku” dhe shumë rrugë të tjera, jo vetëm në qytet, por edhe nëpër fshatra.

Përparim Krasniqi: Këtu jeni duke i përzier kompetencat shumë, po e shoh nga postimet e tua rreth ndriçimit publik. Rahoveci prin për ndriçim publik në nivel vendi, për qytet e për fshat. Për moment ka veprimet të KEDS-it në terren, të cilët po e bëjnë zëvendësimin e shtyllave. Ka lagje që nuk mund të kenë ndriçim publik, pa e përfunduar çështjen KEDS-i. E kemi rastin në Celinë dhe Hoçë.

Lirigzon Kastrati: Çështja e shembjes së rrugës në fshatin Brestoc. Kanë kaluar 6 vite. A ka bazë ligjore që mënjanimin e këtij rreziku ta merr tani e tutje komuna, duke e bërë intervenimin e duhur? Do të vijë me ju edhe te ministri Dimal Basha që t’ia paraqesim këtë problem. E kemi paraqitur kërkesën në emër të banorëve me 300 nënshkrime të Krushës, Nagacit, Hoçës, Brestocit, si dhe një pjesë të qytetarëve të Rahovecit.

Përparim Krasniqi: Është shumë e vërtetë, Lirigzon! Është shembur edhe rruga për Ratkoc, si dhe një pjesë në Retijë që e ka përmendur Hazbija. Por, këtu është rreziku më i madh, për shkak të lartësisë. Ne kemi dërguar kërkesa në ministri dhe si komunë nuk mund ta premtojmë një projekt të tillë (rrugë rajonale). Nëse ministria bën memorandum bashkë me komunën, atëherë shumë shpejt do të zgjidhet ky problem.

Berat Duraku: Drejtor, a është në buxhetin e Ministrisë së Infrastrukturës ky segment rrugor?

Përparim Krasniqi: Në linjë buxhetore është që 2-3 vite, por asnjëherë nuk ka filluar implementimi.

5. Shqyrtimi i raportit të auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Rahovecit për vitin 2025:

Afrim Limani: Auditimi i pasqyrave financiare të Komunës së Rahovecit për vitin 2025, në bazë të raportit përfundimtar ka rezultuar me opinion të kualifikuar, si rezultat i keqklasifikimit në pagesat e kontratës kolektive në vlerë prej 2.289.000. Ky raport, gjithashtu ka prodhur edhe 7 rekomandime, prej tyre 5 janë të përsëritura dhe 2 rekomandime janë të reja. Këto rekomandime konsideroj që janë si rezultat i kontratës kolektive, që përndryshe niveli i zbatimit të rekomandimeve do të ishte më i kënaqshëm. Rekomandimet në fjalë nuk janë të natyrës së rëndë dhe nuk ka ndonjë hapësirë për hetuesi.

Lirigzon Kastrati: Raporti është i kualifikuar kur ka keqdeklarime dhe nëse nuk ka pajtueshmëri. Për neve, si grup i LDK-së është shqetësues progresi në zbatimin e rekomandimeve. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore 2024 dhe 2025 thotë: deri në fund të auditimit për vitin 2025, një rekomandim është zbatuar dhe pesë nuk ishin zbatuar ende. Sipas raportit të auditorit, nuk janë marrë hapat konkret për t’i adresuar këto rekomandime. Kërkoj nga ana e ekzekutivit që rekomandimet e ZKA-së t’i merrni me seriozitet, sepse faturën e këtij raporti e paguajnë qytetarët e komunës së Rahovecit.

Qazim Cana: Faleminderit, kryesues! Dëshiroj të ndalem te gjetjet nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Në 17 raste, me vlerë totale 761.089€ nuk janë paguar brenda afatit të përcaktuar ligjor. Vonesat në ekzekutimin e pagesave kanë qenë nga 17-376 ditë, pas afatit të lejuar për pagesa, i cili është 30 ditë. Kjo është gjetje serioze nga auditori. Vetëm në 6 muajt e parë të këtij viti janë tërhequr 4.5 milionë €, prej tyre mbi 2 milionë janë për operatorë ekonomikë. Të gjitha këto penalizimi i kushtojnë komunës dhe qytetarëve.

Defrim Kafexhiu: Përveç që ka ndërruar struktura e kuvendit, këtë vit ka ndërruar edhe qëndrimi i kryetarit drejt kuvendit komunal. Po vërehet që prezenca e tij nuk është e kënaqshme. Nuk e di se cila është arsyeja, por raporti i auditimit realisht e përjashton komunën prej grantit të performancës. Gjatë mandatit të kaluar, kryetari ka ardhur në seanca vetëm për pikët që janë kriter për pjesëmarrje për grantin e performancës, ndërsa tani mosprezenca e tij lidhet me këtë raport të auditimit, ose ndoshta moskandidimi i tij në zgjedhjet e ardhshme lokale. Raportin e auditimit e kemi diskutuar edhe në vitin 2022, kur ka qenë njëjtë i kualifikuar. Rekomandimet e njëjta dhe moszbatimi i rekomandimeve, si dhe mungesa e tentimit për të ndryshuar diçka është evidende vit pas viti. Ashtu siç po e shoh unë, edhe në këtë raport të auditimit kryetari si zyrtar kryesor administrative dhe si udhëheqës i ekzekutivit, përgjatë vitit vetëm shikojnë ta tejkalojnë punën dhe me shpresën që ZKA-ja nuk na jep raportin e kualifikuar. Raporti i kualifikuar është i dëmshëm për komunën e Rahoveci, për punën e ekzekutivit dhe për qytetarët. Pika A2: Komuna kishte lidhur kontrata me operatorë ekonomikë për projekte kapitale në mungesë të fondeve buxhetore. Para 1 ose 2 seancave Jusuf Dërmala e ka shfaqur si problematikë lidhjen e kontratave në mungesë së fondeve dhe tani po penalizohet komuna me raste përmbarimore, por edhe me urdhëra gjyqësorë. Raporti ka rezultuar me 7 rekomandime, 2 prej tyre janë rekomandime të reja dhe 5 të përsëritura. Ndërtimi i rrugës 4-korsi Rahovec – Xërxë (lot I) në vlerë 7.88 milion: këtu, përkundër memorandumit të mirëkuptimit, auditori ka gjetur se përkundër që ministria nuk ka pasur mjete buxhetore, me kërkesë të Komunës së Rahovecit ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi, ku 6 milionë euro nuk janë paguar dhe nuk ka pasur ndarje buxhetore paraprake. Kjo është e dhimbshme dhe është më mirë që mos të nënshkruhet një memorandum mirëkuptimi i tillë pa bazë, sepse tani komuna mund të ndëshkohet në përmbarim, përveç që është penalizuar në raport të auditimit. Si anëtar i kuvendit dhe në emër të grupit të LVV-së, e ftoj ekzekutivin që të merret intensivisht me implementimin e këtyre rekomandimeve, që tutje mos të penalizohet nga raporti i kualifikuar.

Fahrije Lushi: Drejtor, faleminderit për prezantimin e këtij raporti. Mosprezenca e kryetarit në këtë seancën është diçka joserioze, sepse nuk kam ndonjë informatë që ai ka ndonjë punë më të rëndësishme sesa mbledhja e kuvendit me një raport të kualifikuar të auditimit. Përndryshe, nëse raporti do të ishte jo i kualifikuar, mesiguri kryetari do të ishte këtu dhe do të mburrej për punën. Më kujtohet kur kryetar na ka sjellur planin e veprimit për realizimin e këtyre rekomandimeve dhe ajo që po ndodh është që përveç që nuk realizohen, ato edhe përsëriten. Drejtor, kur e hartoni planin e veprimit, bashkë me kryetari, le të jetë më kredibil që edhe ne si asambleistë ta marrim pak më serioze punën e juaj.

Kryesuesi: Faleminderit, Fahrije! Sa për informatë, kryetari është në një takim me ftesë të Ambasadës Gjermane, për çështjen e një projekti të ri për vitin 2027. Ka arsyetim mosprezenca e tij, sepse ai nuk ka ikur prej luftës, e le më prej seancave.

Fahrije Lushi: Ne nuk jemi të gjykojmë se ku ka ikur e ku jo. Unë thjesht e thash atë që e njoh punën e kryetarit. Askush nuk thash që ka ikur kryetari dhe mos t'i japim kahje gjuhës së kuvendit me atë që mund ta përdorim diku tjetër.

Kryesuesi: Faleminderit, Fahrije! Nuk është term i rëndë "ikja"! Përndryshe, kur nuk është kryetari këtu, e ka nënkryetarin dhe drejtorët e tij.

Yllka Shehu: Te çështja A1 – klasifikimi joadekuat i shpenzimeve: në raportin e auditimit evidentohen bukur mirë për keqklasifikimet e shpenzimeve plot 2.2 milionë euro. Më intereson se cilat janë masat konkrete të ndërmarra, që kjo situatë të mos përsëritet në planifikimin e buxhetit për këtë vit?

Defrim Kafexhiu: Meqenëse Demos-i ka filluar monitorimin e seancave, po më vjen mirë që shumë anëtarë të kuvendit janë aktivë dhe seancat janë më produktive.

Afrim Limani: Lirgzone pyeti për progresin rreth zbatimit të rekomandimeve: të them të drejtën, në raportin e kaluar i kemi pasur 6 rekomandime dhe jam shumë i sigurt që prej këtyre 6 rekomandime, 3 duhet të zbatohen. Mirëpo, vendimi është i tyre dhe situata është kështu siç është. Në fillim e thash, raporti nuk ka gjë të keqe dhe

është cilësuar si i kualifikuar si rezultat i kontratës kolektive. Defrim, kryetari i ka punët e tij dhe kjo është përgjegjësi e imja, sepse këto punë i di më mirë se kryetari dhe për këtë raport flas tërë ditën. Të gjitha komunat e Republikës së Kosovës raportin e auditimit e kanë të kualifikuar, përveç komunës së Junikut. Defrim, the për mungesën e fondeve dhe realisht kjo e gjetur nuk është dashur të jetë aty, sepse fondet janë të Ministrisë së Infrastrukturës. Fahrije, faleminderit shumë për këshillat rreth planit të veprimit.

Defrim Kafexhiu: Respekt për drejtorin e Financave dhe unë besoj që raporti i auditimit do të kishte më shumë të gjetura, nëse Komuna e Rahovecit si drejtor të Financave nuk do ta kishte Afrim Limanin. Sipas ligjit, përgjegjësia komplet i takon kryetarit në zbatimin e rekomandimeve, si dhe në përgatitjen e prezantimit të drejtë të pasqyrave financiare pranë auditorëve. Drejtori e tha që nuk është dashur të jetë rekomandim kur ka ndarje buxhetore nga ministria përkatëse, por këtu duhet të jetë përgjegjëse edhe Komuna e Rahovecit, sepse paraprakisht është lidhur një memorandum mirëkuptimi. Këtu po thuhet që, deri në dalje të rrugës në Xërxë, ritenderimi në vlerë 3.3 milionë në sistemim PIP për vitin 2025 dhe dy vitet vijuese janë paraparë fonde në vlerë 1.0022.000€. Ndërsa, përmes marrëveshjes së mirëkuptimit me Ministrinë e Infrastrukturës janë siguruar 400.000€ dhe nga kjo rezultojnë një mungesë e fondeve për realizimin e projekteve në vlerë 1.8 milionë euro. Pra, 1.8 milionë euro nuk i keni parashikuar dhe nuk i keni vendosur në sistemin PIP. Në këtë sistem evidentohen investimet dhe vlera e garantuar e mjeteve, kur ka ndarje buxhetore.

Lirigzon Kastrati: Drejtor, dua të të pyes për një të gjetur tjetër, që ka të bëjë me sistemin E-prokurimi dhe ka rezultuar me gjetje nga ana e auditorit. (zërim i dobët)...

Afrim Limani: Defrim, çdo organizatë buxhetore e ka sistemin PIP (Programi i Investimeve Publike), vendi ku duhet të futen të gjitha investimet kapitale, bashkë me projeksionet e buxhetit. Supozojmë që një projekt është 500.000 dhe sivjet i vendosim 100.000, mirëpo në dy vitet e tjera duhet ta mbulojmë, sepse përndryshe do të jetë e gjetur e auditorit. Në këtë rast, ne e kemi një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe ata nuk i kanë futur të dhënat në sistem dhe ku ta di unë se si ata e kanë paraparë financimin e projektit. Një e gjetur tjetër që e përmendi Lirigzoni, që konsideroj që është me vend është edhe futja e të dhënave në sistemin E-prokurimi. Në këtë rast, nuk e kemi bërë dhe kjo ka rezultuar me gjetje. Besoj që vitin e ardhshëm ky rekomandim do të zbatohet.

6. Shqyrtimi i raportit gjashtëmuor i punës së Zyrës së Prokurimit për vitin 2026:

Astrit Mullabazi: Faleminderit! Nga këto 6 muaj janë 25 aktivitete të prokurimit, me vlerë 2.573.000. Janë nënshkruar gjithsej 6 kontrata me vlerë 643.000. Një aktivitet i prokurimit është anuluar. 18 aktivitete të prokurimit kanë qenë në procedurë të prokurimit. Në këtë 6 muaj është anuluar një aktivitet i prokurimit, por tani me ritenderim është nënshkruar kontrata. Vlera e kontratave të nënshkruara deri më tani është 2.119.000€. Raporti vjetor për kontratat e nënshkruara publike është konfidencial deri më 15 shkurt 2027 dhe në këtë datë publikohet në ueb-faqen e komunës.

Defrim Kafexhiu: Këtë raport e kemi pasur edhe në KPF, ku zyrtari nuk ka qenë i pranishëm. Në KPF e kam thënë që ky nuk është raport dhe nuk mund të vlerësohet si i tillë, ose në është ky raport i punës, atëherë aty nuk bëhet punë. Është turp për institucionin e komunës edhe nëse bëhet publikimi i këtij raporti, kështu siç është. Prokurimi është zyra më e rëndësishme e Komunës së Rahovecit dhe nuk shkon që raporti të jetë me 5 rreshta. Duhet të specifikohet raporti me më shumë detaje. Kërkoj që kjo pikë të shtyhet për seancën e radhës, të paktën jo të prezantohet, por si dokument ta kemi një raport më të plotësuar. Më falni, se ndoshta u shpreha në mënyrë jo-institucionale, sikur LDK-ja, por ky është realiteti.

Lirigzon Kastrati: Të shprehesh si LDK-ja të duhet kohë dhe këtë kohë nuk e arrin dot! Zyra e Prokurimit në nivelin lokal është njësi përgjegjëse brenda administratës komunale që menaxhon me tenderët. Kërkoj nga zyrtari përgjegjës i prokurimit se cilat janë këto 5 kontratat që raporti i auditimit ka dalë si bazë për kualifikim? E dyta,

në zyrën e prokurimit, a nënshkruhet një deklaratë për disponimin e mjeteve për hapjen e tenderit dhe kush e bën atë?

Astrit Mullabazi: E sqarova që, raporti vjetor i kontratave të nënshkruara publike publikohet në faqe të Komunës pas njoftimit nga komisioni rregullativ i prokurimit publik. Përkatësisht, publikimi i kontratave është konfidencial deri në vitin 2027. Lirigzon, sa i përket menaxhimit të kontratave, zyra e prokurimit e bën prej inicimit të aktivitetit të prokurimit deri te nënshkrimi i kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës, kryetari me vendim e cakton një person përgjegjës si menaxher dhe një person tjetër si mbikëqyrës i drejtpërdrejt i menaxherit të kontratës. Në E-prokurim është përgjegjës menaxheri i kontratës. Sa i përket deklaratës së nevojave, është menjëherë pas kërkesës për shpalljen e një tenderi. Deklarata e nevojave nënshkruhet nga drejtoria përkatëse që e shpall tenderin, nga zyrtari kryesor financiar, si dhe nga zyrtari kryesor administrativ.

Kryesuesi: Një pyetje: Ky raport 6 mujor, meqenëse publikohet në vitin vijues, a është obligativ të diskutohet tani në kuvend? Nëse nuk është obligativ, atëherë hiç mos ta trajtojmë. Vazhdojmë me pauzë...

7. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim-plotësimit të Rregullores 01Nr.23 të datës 30.03.2023, për Menaxhimin e Mbeturinave në Territorin e Komunës së Rahovecit:

Kryesuesi: Meqenëse tani e kemi këtu kryeshefin ekzekutiv, z. Burim Shala dhe për shkak të angazhimeve të tij, me mirëkuptim, po e trajtojmë tani këtë pikë të rendit të ditës. Fillimisht, e ftoj drejtorin e Shërbimeve Publike.

Përparim Krasniqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar kryeshef! Para jush e keni plotësim-ndryshimin e rregullores për menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë edhe taksën për mbeturina apo ndryshimi për amvisëri. Ndryshim do të ketë vetëm te pjesa tabelare në fund, te pjesa çmimore e rregullores.

Defrim Kafexhiu: Kjo rregullore nuk është drafti i plotësim-ndryshimit, është rregullorja e vjetër? Gjithashtu, nuk janë përfshirë çmimet e reja?

Përparim Krasniqi: E vërtetë, tani do të diskutojmë.

Burim Shala: Faleminderit, kryesues! Përhëndetje për drejtorët, asambleistët dhe qytetarët e pranishëm. Para 10 dite e kemi pasur një dëgjim publik këtu, kam qenë dhe e kam arsyetuar me mundësitë e mia. Disa asambleistë kanë qenë pjesë e dëgjimit, por shumica jo. Rritja e tarifave ka ardhur si arsyetim i shpenzimeve si ngritja e çmimit të naftës dhe ngritja e çmimit të deponisë në Landovicë (një ngritje prej 100%), si dhe ngritja e çmimit të uniformave (50%). Komuna e Rahovecit, nga janari deri në maj ka shkuar në humbje të kompanisë 38.899€ dhe kjo i bie që ka pasur më shumë shpenzime sesa hyrje. Në komunën e Rahovecit inkasimi është dukshëm mirë dhe kjo rritje nuk po ndodh vetëm këtu, komuna e Rahovecit është e fundit që po bëhet ky plotësim-ndryshim. Dje e kemi bërë ngritjen e tarifës në komunën e Malishevës dhe para dy muajsh e kemi bërë në Suharekë (7.5€), ndërsa Gjakova e ka bërë ngritjen 8.7€. Pra, siç e cekta më herët, komuna e Rahovecit ka pasur humbje dhe nëse vazhdojmë kështu, atëherë është rrezik për kompaninë. Realisht rritja është menduar në 7.5 dhe unë kam thënë që të jetë 8, rritje e cila ndikon direkt në rritjen e pagave të punëtorëve rreth 71.70€ në bazë të koeficientit, nëse rritja bëhet 8€, atëherë do t'i bëjmë edhe sigurimet shëndetësore 33€ dhe i bie që për secilin punëtor rritja e pagës të jetë 105€.

Përparim Krasniqi: Propozimi ynë është 7.5€ për amvisëri. Pjesa tjetër është e konsumatorëve institucional, që me rregulloren e vjetër 6.7€ dhe propozimi është 8-10€, për arsye që: Ekoregjioni ka të drejtë të bëjë kontratë me biznese dhe i kategorizon mbeturinat (p.sh një frizer mund ta ketë një punor, por tjetri mund t'i ketë dhjetë) Pjesa tjetër te bankat, mikrofinancat 25-30€. Pjesa e kategorisë së fundit, avokaturë dhe agjencitë është 8-10€. Zona e dytë, tarifë mujore 10-12€, zona e tretë 12-14€, e katërta 15-17€ dhe e fundit - hotelet, hotelet me kapacitete më të mëdha e kanë 25-30€. Këto janë propozimet tona, ju lus që t'i shqyrtoni.

Lirigzon Kastrati: Kryeshefi na tha që kemi pasur humbje 88.000€, për cilat vite ka qenë kjo humbje? Sa i përket tarifave, propozimet tona në emër të grupit i kemi dhënë edhe në diskutimin publik. Jemi e vetmja komunë që kemi pasur rritje para dy viteve nga 4.5€ në 6 dhe propozimi për çështjet e njësisve familjare ka qenë 6.5€.

Feriz Thaqi: E kam një pyetje për kryeshefin! Më intereson tarifa e familjeve që nuk jetojnë në Kosovë, paguajnë mbeturina, por nuk janë rezident. Sa është tarifa për ata?

Burim Shala: Po, e vërtetë që kemi qenë në humbje 38.000 (janar-maj) dhe nëse shkohet me këtë ritëm, i bie që për 1 vjet kompania do të ketë humbje, veç në komunën e Rahovecit rreth 93.000. Sa i përket asaj që the, rritjen e tarifave e ka bërë veç komuna e Rahovecit, kjo nuk qëndron, sepse para dy viteve e kanë bërë të gjitha komunat: Malisheva, Dragashi dhe Prizreni. Sa i përket tarifës për jorezidentët, komuna e Rahovecit e ka 27 euro në vit, propozimi ynë është 36 euro. Me propozimin e juaj për 6.5euro për amvisëri, komuna e Rahovecit nuk mund të funksionojë, sepse në mungesë të mjeteve financiare nuk ka paga për punëtorë dhe krijohet një situatë e tillë që mbeturinat të mbesin aty. Mos ta harrojmë faktin që, komuna e Rahovecit e ka larg deri në 100km në javë deponinë e Landovicës. Në krahasim me Suharekën, këtu janë shpenzimet edhe një herë më të mëdha.

Jusuf Dërmala: Një pyetje për kryeshefin, nëse ka menduar ndonjëherë për punën e reciklimit dhe ndarjes së mbeturinave. Kjo do të ishte një ide më e mirë për ta rritur profitin në kompanin e juaj, sesa t'i rrisim çmimet.

Besnik Hoti: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Më intereson rreth mbetjeve shtazore, çfarë zgjidhje kemi për momentin?

Burim Shala: Sa i përket çështjes së reciklimit, sot e kemi pasur një takim dhe gjithashtu kryetari i komunës tani është në Prizren dhe temë diskutimi me BE-në dhe GIZ-in është çështja e reciklimit. Çështja e reciklimit lidhet direkt dhe i përket komunave, si dhe ministrisë. Sipas ligjit, kompania Ekoregjioni është vetëm mbledhës i mbeturinave. Sa herë që i marrim mbetjet shtazore, paguajmë 100 euro pjesën në Landovicë për asgjësim. Përsëri, edhe çështja e mbetjeve shtazore është çështje e nivelit qeveritar.

Lirigzon Kastrati: Unë e ngatërrova dhe e thash 88.000 ka qenë humbje, në realitet qenka 33.000. Atëherë, në vitin 2025 si ka operuar njësisia e Rahovecit, me të hyra dhe me shpenzime?

Burim Shala: Në vitin 2025 ka pasur humbje 28.000. Raportin e 2025 nuk e kam me veti, por e di që e kam dorëzuar diku. Zakonisht dorëzohet te aksionarët. KMDK-së ia kemi borxh deri më tani 300.000€

Lendrit Morina: Në kërkesën që e patëm për rritje 7.5, propozoj që të shkojmë me 8. Rritja prej 0.50 centë të shkojë direkt për punëtorët e Ekoregjionit. Me të vërtetë, rroga prej 406euro e një punëtori të Ekoregjionit është mjaftë e ulët.

Feriz Thaqi: Tarifa për banorët jorezidentë është 36 euro, ose 3 euro në muaj. Propozoj që të bëhet 48 euro, ose 4euro në muaj.

Përparim Krasniqi: Nuk kemi dashur të shkojmë me ngritje enorme me 8, por ndoshta për punën që e bëjmë ata edhe 10 është pak. Për amvisëri, propozojmë që të shkojmë me 7.5, sepse ndoshta edhe vitin tjetër, donatorët ose ministrua do të na detyrojnë që të bëjmë përsëri ngritje. 7.5 është e mjaftueshme për qytetarët tanë.

Defrim Kafexhiu: Unë kam qenë pjesë e konsultimit publik, që ka qenë për rritjen e tarifave të shërbimeve për amvisëri. Fillimisht, e kam një vërejtje, sepse paraprakisht nuk e kemi pranuar ndonjë material që e ka tabelarin me ndryshimet që po prezantohen. Prej të gjithë pjesëmarrësve në konsultim publik, nuk e kam parë që dikush të jetë kategorikisht kundër, duke u bazuar edhe në rrethanat dhe kohën që jemi duke jetuar. Përndryshe, shumica pajtohem që po bëhet një punë e mirë nga Ekoregjioni. Në ligjin për ndërmarrjet publike, që përfshihen edhe ndërmarrjet publike lokale, nuk specifikohet që kur ka disa njësi që e përmbëjnë një ndërmarrje publike lokale që të decentralizohen njësitë. Kjo rregullohet me rregullore të brendshme të kompanisë, të cilat nuk janë publike. Do të ishte më transparente nga ndërmarrja që të jenë publike edhe këto rregullore, sepse fitimet e kompanisë varen prej inkasimit brenda territorit që operojnë. Duke e marrë parasysh që ky fitim do të shpërndahet te punëtorët, apo edhe te makineria që nevojiten për shërbime të qytetarëve, në parim jam "pro" rritjes. Ajo që dëshiroj është që mos të detyrohem përsëri që pas një viti prapë ta votojmë, por kjo rritje të jetë për një periudhë të caktuar. (probleme teknike me zërim)*

Kryesuesi: Faleminderit! A ka dikush diçka tjetër?... Nëse jo, atëherë e kemi një propozim të Lirigzonit me 6.5. Lendriti është tërhequr prej propozimit dhe e kemi një propozim të Ferizit, si dhe në fund propozimin e drejtorisë së Shërbimeve Publike.

Feriz Thaqi: Kërkoj që propozimi im të vendoset në votim. Nga 3 të bëhet 4, tarifa për banorët jorezidentë.

Kryesuesi: Paraprakisht, para se ta vendosim në votim, kërkoj që Mentor Veliu ta lirojë sallën për arsye të pozitës që e mban dhe të mos kemi konflikt interesi.

Përparim Krasniqi: Tarifa kryesore (amvisëria) 7.5€. Kategoritë e tjera kanë më pak klientelë.

Kryesuesi: Gjithashtu, në procesin e votimit le ta liron sallën edhe kryeshefi. Tani, po e vendosi në votim propozimin e Lirigzonit me 6.5€. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 5 vota “për”, 12 kundër dhe 2 abstenime, bie propozimin i Lirigzonit. Po e vendosi në votim propozimin e Feriz Thaqit, që tarifa për banorët jorezidentë të jetë 4€ mujore. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenime?... Me 13 vota “për”, 4 abstenime dhe asnjë kundër, miratohet propozimin i Ferizit. Po e vendosi në votim tarifën e prezantuar nga drejtoria e Shërbimeve Publike. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 16 vota “për”, 5 kundër dhe 2 abstenime, miratohet rregullorja për menaxhimin e mbeturinave.

8. Shqyrtimi i informatës nga drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, janar – qershor 2026:

Behar Thaqi: Faleminderit, kryesues! I nderuar nënkryetar, kolegë drejtorë, anëtarë të kuvendit. Gjatë periudhës janar-qeshor 2026, drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural ka zhvilluar aktivitetet e saj në rrethana jo të lehta financiare. Mosalokimi me kohë i buxhetit dhe tërheqja e mjeteve nga thesari ka ndikuar drejtpërdrejt në dinamikën dhe organizimin e projekteve të planifikuara. Megjithatë, falë punës së drejtorisë dhe mirëmenaxhimit të buxhetit janë lidhur kontrata afër 1 milion €. Gjatë muajit janar, komuna jonë u përball me vërshime, ku pati dëme të konsiderueshme. Drejtoria jonë mori masa emergjente në sanimin e rrugëve fushore, urave, si dhe kanaleve kulluese. Në kuandër të mbështetjes së fermerëve dhe te procedura e aplikimit për subvencione të Ministrisë së Bujqësisë, në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2025 kanë aplikuar 187 fermerë në sektorin e blektorisë. I kemi mbështetur edhe 1146 fermerë me pleh artificial, ndërsa 150 fermerë kanë përfutur inpute bujqësore për trangujt kornishan dhe specit. Në sektorin e shëndetit të kafshëve është realizuar vaksinimi falas në 1446 krerë bagëtish në 128 ferma të komunës sonë. 310 vreshtarë kanë përfutur preparat për luftimin e sëmundjes Cikadia. Ndërsa, projekti për trajtimin e vreshtave me dron është në procedurë të prokurimit dhe pritet të realizohet gjatë fazës së dytë të këtij viti. Janë rregulluar rreth 8.5km rrugë fushore dhe janë reabilituar 6 ura të dëmtuara nga vërshimet, si dhe janë pastruar rreth 9.7km kanale kulluese dhe përrenj. Informatën e detajuar e keni para vetes dhe për çdo pyetje jam këtu.

Bujar Mustafa: E kam një koment: në informatë thotë se, sëmundjen më të shpeshta që paraqiten në regjionin tonë janë tuberkulozi dhe bruceloza. Ndoshta ky është gabim teknik, sepse nëse këto janë të shpeshta, atëherë Rahovecin duhet ta fusin në karantinë, sepse janë zoonozat, sëmundje që nga kafshët bartet në njerëz. Ky është gabim teknik dhe është mirë që ta përmirësoni.

Hazbije Shala: Dua ta ngris një çështje të fshatit Zoqishtë. Në raportin 6-mujor të Komunës së Rahovecit, te pika 8 është evidentuar pastrimi dhe mirëmbajtja e përroit në fshatin tonë. Përkundër kësaj, realiteti në Zoqishtë është krejtësisht ndryshe. Përreth 500-600m shtrati i lumit mbetet ende i parregulluar dhe pa u pastruar. Kërkoj nga organet komunale që të ndërmarrin masa të qëndrueshme, si dhe për trajtimin e ujërave të kanalizimit.

Sali Sallteku: E falënderoj drejtorin për informatën. Drejtor, ku jemi me korrje-shirje, për shkak të motit? Këto dëmet që janë bërë së fundmi, a i keni parë?

Defrim Kafexhiu: E kam parë që është hapur thirrje që të paraqiten dëmet e shkaktuara në shtëpitë private dhe në bujqësi. Së pari të paraqiten dëmet dhe më pas komisioni t'i vërtetojë. Besoj që te kjo pjesë nuk duhet të vonohet shumë dhe duhet të bëhet urgjent një komision i komunës, sepse deri sa shkon komisioni për vizitë, qytetari e

rregullon dëmin e shkaktuar nga stuhia ose shiu, sepse nuk mund të qëndrojë pa kulm mbi kokë. Fillimisht dhe pa humbur kohë, komisioni duhet të dalë në terren dhe t'i verifikojë dëmet.

Lirigzon Kastrati: Kemi kërkesë të domosdoshme për intervenim në rrugë fushore. Në diskutimet që i kemi pasur me drejtorin, ka thënë që deri në fundvit pritet të hapen tenderë për zgjerimin dhe rregullimin e rrugëve fushore. Ndër tjerash, është shqetësuese nga ana e qeverisë se si ende nuk i kanë kompenzuar dëmet. Në janar të këtij viti, me sa kujtoj, i kemi votuar tre raporte për kompenzimin e dëmeve në bujqësi dhe ekonomi familjare. Deri më tani, nga qeveria nuk është kompenzuar asnjë raport. Njëjtë është duke vazhduar edhe tani, sepse ende nuk e kemi një zotim nga qeveria që këto dëme do të kompenzohen. Kërkoj të na njoftoj drejtori nëse ka komunikuar me institucionet qeveritare për këtë çështje? Raportet pothuajse po mbesin veç në letër dhe i fundit që po dëmtohet është bujku i komunës sonë.

Behlul Krasniqi: E kam një shqetësim, sepse është bërë e tepërt prej vitit 2021. Një njeri ka aplikuar për dëme për vreshta dhe për 5 ha i ka marrë 47€. Prej 2021 sa i përket dëmeve asnjë centë nuk është lëshuar nga qeveria dhe tani pothuajse bujqit dhe qytetarët nuk kanë vullnet për aplikim. E lus drejtorin të bëjë presion në këtë drejtim.

Berat Duraku: E falënderoj drejtorin për informatën. Gjithashtu, e falënderoj edhe për angazhimin që po e bën.

Behar Thaqi: Sa i përket përroit në fshatin Zoqisht, duhet të intervenojmë vetëm kur ka ujëra atmosferik, sepse drejtorisë sonë nuk i përket të përfshihet aty ku qarkullojnë ujërat fekale. Bujar, raporti i veterinarit thotë: sa i përket gjendjes shëndetësore të kafshëve më e cekur ka qenë kjo sëmundje, ndoshta janë gjithsej dy sëmundje. Baca Sali, sipas terrenit korret kanë arritur deri në 95% dhe rendimenti mesatar sillet 5000 kg për hektar. Pritet t'i kemi 2800-3000 ha të mbjellura me grurë. Behlul, komisioni është formuar në janar, dje është riaktivizuar dhe sot ka dalur në terren dhe deri më tani janë gjithsej 50 kërkesa të parashtruara për dëme.

9. Shqyrtimi i raportit të komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës:

Artan Asllani: E përshëndes kryesuesin, nënkryetarin, drejtorët dhe asambleistët. Me vendim të kryetarit të komunës është formuar komisioni për verifikimin e të gjitha pronave, që ekskluzivisht kanë kontratë me drejtorinë e Ekonomisë. Në raport janë shënimet e detajuara për të gjitha bizneset, për pronarët fizikë apo juridikë të cilët kanë kontratë me drejtorinë e Ekonomisë. Gjithsej janë 41 kontrata të menaxhueshme dhe 37 prej tyre janë afatmesme, 1 është deri në një vjet dhe 3 prej tyre janë kontrata afatgjate.

Lirigzon Kastrati: Faleminderit, Artan! Ky raport nuk është thjesht një dokument administrativ, është raport që prek drejtpërdrejt atë se si menaxhohet prona publike, e cila është pasuri e të gjithë qytetarëve të komunës së Rahovecit. Ju rikujtoj që ky raport është kërkuar, sepse kam konsideruar se kuvendit duhet ta ushtroj funksionin e mbikëqyrjes dhe të sigurohet që prona komunale të administrohet në mënyrë të ligjshme. Në çdo kontratë të lidhur duhet të respektohet ligji, kushtet e kontratës dhe detyrimet financiare dhe nëse konstatohet e kundërta, atëherë institucionet komunale duhet të ndërmarrin masa konkrete dhe mbikëqyrje të vazhdueshme, me qëllim të vetëm që ta rrisin llogaridhënien për qytetarët. Në raport po e shoh që gjithsej deri më tani, obligime të papaguara janë 102.000. Pres nga komisioni që deri në fund të vitit ta bëjë punën e vet dhe që këto obligime të inkasohen.

Artan Asllani: Faleminderit, Lirigzon! Bazuar në terren, është lajm i mirë për qytetarët se prona publike e komunës së Rahovecit është mjaft e mirëmbajtur, si dhe me investime të prekshme. Në gjashtëmujorin e parë inkasimi është i kënaqshëm, por edhe në gjashtëmujorin e dytë shumë prej bizneseve do t'i kryejnë obligimet e tyre të mbetura dhe deri në fund të vitit obligimet do të jenë zero.

Lirigzon Kastrati: Artan, këtu po i shoh disa rekomandime që i keni marrë! A do t'ia dërgoni kryetarit këto rekomandime? Si do të veproni?

Artan Asllani: Po, patjetër! Deri më tani është bërë shkëputja e një kontrate, ndërsa edhe një operator tjetër është në fazën e përmbaruesit.

Lirigzon Kastrati: Këtu e kemi një rast kur një biznes shfrytëzohet nga pala e tretë! A kemi raste të tjera të tilla?

Artan Asllani: Komisioni është vetëm për rekomandin dhe në bazë të rregullores operatori ekonomik që lidh kontratë me komunën e ka të cekur në kontratë që, pala e dytë nuk ka të drejtë t'ia jap palës së tretë.

Defrim Kafexhiu: Te kolona 11: borxhi i akumuluar deri në qershor, Ura e Shenjtë 4262€. Komisioni a i dërgon vërejtje? Këtu e pashë vetëm një rekomandim për shkëputje të kontratës, te lokali i Ismet Canës. Tani lokali është funksional! A keni ndonjë problem në koalicion?

Artan Asllani: Komisioni nuk ka të drejtë t'ju jap vërejtje qiramarrësve, por vetëm zyrtari kompetent, i cili është Fidan Hoti.

Defrim Kafexhiu: Një herë e kam diskutuar për vlerën e qirasë për dhënie në shfrytëzim të pronave të komunës dhe pikërisht për rastin në fjalë. Qiraja mujore për terracë po i bjen 387€ dhe obligimi është 4262€. Kjo i bie që ky nuk ka paguar që një vjet e gjashtë muaj. Nëse e the që te përmbaruesi e dërgon në fund të vitit, pse në fund të vitit të kaluar kjo çështje nuk ka shkuar te përmbaruesi? Si ia bëni me dikë që është te përmbaruesi dhe i ka skaduar kontrata dhe si e inkason komuna atë borxh?

Artan Asllani: Para se t'i skadojë kontrata, ne vazhdojmë me procedura dhe paraprakisht e njoftojmë, sepse e kemi obligim ligjor. E thash në fillim, që në kontratë e ka të specifikuar që pagesa duhet të jetë çdo muaj. Në bazë të rekomandimeve, në 6-mujorin e parë dhe në të dytin, ne i dërgojmë vërejtje me shkrim dhe nëse nuk bëhet pagesat nga operatori ekonomik, atëherë lënda shkon në përmbarues.

Kryesuesi: Faleminderit, Artan! A ka dikush tjetër ndonjë diskutim? Nëse jo, e falënderoj Artanin për përgatitjen e këtij raporti, si dhe për përgjigjet e tij të sakta dhe precize.

10. Shqyrtimi i raportit vjetor mbi menaxhimin e pasurive të Komunës së Rahovecit për vitin 2025:

Asllan Mazreku: Përshëndetje për të gjithë! Raporti paraqet rezultatet e procesit të regjistrimit dhe inventarizimit të pasurive komunale të Komunës së Rahovecit për vitin 2025. Raporti është hartuar në përputhje me rregulloren dhe procedurat në fuqi, si dhe bazohet në të dhënat zyrtare, të verifikuara në sistemet përkatëse të menaxhimit të pasurive komunale. Me vendim të kryetarit, janë formuar 4 komisione: komisioni për regjistrimin e aseteve, komisioni për inventarizim, komisioni për tjetërsim dhe komisioni për asgjësim. Të gjitha punët e komisioneve përkatëse i keni të paraqitura në raport. Në bazë të raportit përfundimtar, numri i aseteve komunale jofinanciare të regjistruara është 31.844. Janë regjistruara 138 objekte komunale dhe prej tyre 44 janë në shfrytëzim, 6 objekte janë të dëmtuara dhe jashtë funksionit, si dhe 88 objekte janë funksionale. Të evidentuara janë 56 vetura, 4 prej tyre janë jashtë përdorimit. Në raport i gjeni të gjitha pasuritë e komunës të elaboruara me detaje mbi menaxhimin e tyre.

Yllka Shehu: Prej 31.050 aseteve që janë në përdorim, 794 prej tyre janë jashtë përdorimit. Pse janë jashtë përdorimit dhe a janë zëvendësuar me asete të reja? Duke marrë parasysh koston më të ulët, ndoshta do të ishte më mirë që të riparohen sesa të zëvendësohen.

Defrim Kafexhiu: Të pashfrytëzueshme janë 28 objekte të AMF-ve dhe QMF-ve. Meqenëse kryetari tani është këtu, e pyes nëse ka ndonjë planifikim për shfrytëzimin e këtyre objekteve, qoftë për ndonjë destinim tjetër? Te pjesa e veturave të shfrytëzueshme, a përfshihen edhe veturat e QKMF-së?

Asllan Mazreku: Asetet që janë jashtë përdorimit i kemi vendosur në shitje përmes ankandit publik. Për fat të keq, hera e dytë është që nuk ka fare ofertues. Nuk mund të riparohen, sepse janë shumë të dëmtuara. Defrim, janë të gjitha veturat, kompet. Përmes ankandit, deri më tani janë shitur 7 vetura.

11. Raporti i DKA-së për fundvitin mësimor, 2025-2026:

Muhamet Morina: I nderuar kryetar, kryesues, drejtorë, asambleistë të respektuar. Shumicën e aktiviteteve i kemi paraqitur edhe në raportet e mëparshme, ndërsa në këtë raport i kemi paraqitur kryesisht aktivitetet që i ka zhvilluar DKA-ja në gjysmëvjetorin e dytë të vitit mësimor 2025-2026. Gjysmëvjetori ka filluar më 8 janar dhe në atë kohë jemi dëshmitarë që ka pasur vërshime të mëdha në komunën tonë, që u shkak u bë që në disa shkolla të mos fillojë

mësimi i rregullt. Gjatë gjysmëvjetorit të dytë është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet DKA-së dhe një organizate të pavarur me emrin Voluntary... (probleme me zërim). Qëllimi i kësaj marrëveshje është zbatimi i aktiviteteve në kuadër të mësimit profesional. Kjo organizatë i zhvillon edukatorët e çerdheve tona, për t'i aftësuar më shumë në punë, me metodologji të kësaj organizate me seli në Itali. Kemi vazhduar me marrëveshje bashkëpunimi në mes IAAP-së dhe DKA-së për praktikë profesionale, për nxënësat e ekonomisë dhe juridikut në hapësirat drejtoritë komunale. Gjatë kësaj kohe është funksionalizuar ekipi për planifikimin, mbikëqyrjen dhe mbështetjen e shkollave në realizimin e procesit të mësimdhënësve për licencim dhe rilicencim. DKA-ja ka hartuar planin e veprimit për aktivitetet e psikologëve dhe pedagogëve. Kemi hartuar planin e veprimit të DKA-së për reformën e sistemit arsimor në komunën e Rahovecit. Nga policia kanë vazhduar vizitat nëpër shkolla. Është organizuar dhe mbajtur kuizi i diturisë me nxënësit e 4 shkollave dhe në vazhdim do të bëjmë kuiz me të gjitha shkollat e komunës së Rahovecit. Kanë ndodhur disa investime në rrethojat e shkollës "Gëzim Hamza – Piktori" dhe njëkohësisht edhe evituar rreziku për nxënësit. Kemi shqyrtuar dostet e mësimdhënësve, për ta zgjedhur mësimdhënësin e vitit. Në bashkëpunim me DKRS-në, me nxënësit të tri shkollave, kemi organizuar vizitë në objektet e trashëgimisë kulturore të komunës sonë. Kjo ishte edhe kërkesë e asamblesitit Defrim, kërkesë të cilën paraprakisht e kemi realizuar. Kanë ndodhur shumë aktivitete dhe në raport janë të përfshira të gjitha. Për çdo pyetje jam këtu.

Kryesuesi: Faleminderit drejtor, për këtë raport të detajizuar. I kam disa pyetje: Në faqen e parë, për vitin shkollor 2026-2027 në çerdhe janë regjistruar 191 në Rahovec, Xërxë 63, Ratkoc 10 dhe Krushë e Madhe 1. Është veç 1 fëmijë në Krushë? Sipas matematikës tim, 62 fëmijë më pak të regjistruar në krahasim me vitin e kaluar. Në faqet e tjera, i mirëparaqitur është raporti i mungesave të nxënësve në detaje. Si sugjerim, në raportet e tjera të përfshihen edhe mungesat e stafit arsimor dhe cili është sanksioni i DKA-së, për orët e humbura nga mungesa e arsimtarëve? Në fund, për testin e maturës, sipas përqindjes së shkollave qëndrojmë mjaft dobët.

Lirigzon Kastrati: Kuvendit i ka munguar një raport i tillë. E falënderoj drejtorin dhe e inkurajoj që çdo vit të kemi raporte të tilla të gjendjes në arsim. Gjendja e arsimit në komunën tonë fatkeqësisht është shqetësuese. Vetëm 38.84% është rezultati mesatar në testin e arritshmërisë dhe ky është tregues serioz për sistemin tonë arsimor. Shqetësuese gjithashtu janë edhe mungesat e shumta të nxënësve, veçanërisht ato paarsye. Pajtohem me kryesuesin, i cili tha që në këtë raport duhet të futen edhe mungesat e mësimdhënësve. Sa i përket aktiviteteve, poashtu duhet falënderuar donatorët. Në fshatin Hoçë e Vogël, një bashkëqytetar ka investuar në perde në shkollë, gjë për të cilat gjatë mandatit të kaluar kam kërkuar vendosjen e tyre dhe meqë nuk është bërë kjo gjë, drejtori i shkollës ka bërë kërkesë për një intervenim të tillë.

Qazim Cana: A do të organizohet sivjet mësim joformal? Po e specifikojmë shkollën e mesme "Selajdin Mullabazi - Mici", a ka kandidatë të interesuar për këtë lloj mësimi?

Zana Qanta: Përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për fjalën, kryesues! Sugjeroj që herën tjetër Lirigzoni të flet ka fundi, sepse e elaboroi komplet raportin. Një shqetësim: mungesat e nxënësve prej klasës së parë deri në klasë të pestë, me arsye janë 17.201 dhe paarsye 7283. Ndërsa prej klasës së 6-9, me arsye janë 25.239 dhe paarsye 22.265. Këtu e shohim që kemi mungesa të shumta dhe në anën tjetër rezultatet në testet e arritshmërisë nuk janë aspak të kënaqshme. Më intereson të di nëse është bërë ndonjë analizë konkrete për këtë çështje dhe çka po bëhet në praktikë, që numri i mungesave të zvogëlohet? A po analizohet lidhja në mes mungesave dhe rezultateve të arritshmërisë? Mendoj që këto dy çështje nuk duhet t'i shohim të ndara. Nëse një nxënës mungon në mësim, normalisht që ndikon edhe në përgatitjen dhe në rezultatet e tij.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Në disa shkolla të komunës së Rahovecit, e dimë që ka fëmijë me nevoja të veçanta (autizëm dhe sindrom down). Këta fëmijë shpesh kanë nevojë edhe për mbështetje individuale nga asistentët të angazhuar. A ka komuna e Rahovecit asistentë për fëmijë me nevoja të veçanta në shkollat tona? Sa është numri i

tyre dhe në cilat shkolla janë të angazhuar? Nëse nuk ka asistentë, a ka DKA-ja plan për t'i angazhuar, në mënyrë që këta fëmijë të kenë mbështetjen e nevojshme në procesin mësimor?

Bujar Mustafa: Për riparimin e nyjeve sanitare në shkolla, a duhet që drejtorët të bëjnë kërkesë për vlerësim të gjendjes, apo keni ekip që merret me këtë punë? Pyetja e dytë: në raport thuhet që “do të hapim konkurs për plotësimin e kuadrove”. A është fjala për kuadro të reja, apo sistemim të kuadrit ekzistues? Një pyetje tjetër: nëse një drejtor shkolle merr vetëiniciativë për riparimin e shkollës, a duhet t'i dal në ndihmë komuna?

Nehar Shala: Faleminderit, kryesues! E përgëzoj drejtorin për këtë raport shumë përfaqësor. I kam dy pyetje. E para, njëjët si Vlora që i përmendi asistentët për fëmijët në nevojë dhe e dyta është më shumë shqetësim. Bëhet fjalë për oborrin e shkollës së mesme në Krushë të Madhe “Ukshin Hoti”. Mendoj që aty duhet të intervenohet duke filluar nga porta kryesore, sepse në mbrëmje vinë aty grupe të ndryshme të personave dhe nuk dihet saktë se çka bëhet aty.

Behlul Krasniqi: Drejtor, pse në raport nuk janë paraqitur mungesat e nxënësve në shkollat e mesme?

Hazbiye Shala: E përgëzoj drejtorin për këtë raport. Pyetja ime: sa është numri i nxënësve në klasë të parë dhe numri i nxënësve të regjistruar në shkolla të mesme?

Sali Sallteku: E falënderoj drejtorin për këtë raport! E di që kemi problem edhe me numër të nxënësve, si dhe të punëtorëve. Pyetja është kështu: A do të ketë problem me ndonjë shkollë satelite që do të mbyllet këtë vit?

Defrim Kafexhiu: Te çështja e mungesave: duhet ta kemi të qartë që përgjegjësia është edhe mbi institucionin e drejtorisë së Arsimit, drejtorëve të shkollave dhe mësimdhënësve. Nuk e di saktë, por besoj që numri i mungesave ka rritje vit pas viti. Kur arrihet limiti i mungesave të një nxënësi, format e transferit në shkollat e tjera nuk është produktiv. Duhet të ndryshohet diçka dhe duhet të ndërmerri veprime si institucion lokal i arsimit. Te suksesi i nxënësve: prej klasës së parë deri në të pestën të kemi përsëritje të klasave është shqetësuese. Besoj që problemi është më shumë te mësimdhënësi sesa te nxënësi. Është shumë shqetësuese që klasën e parë e paskan përsëritur 23 nxënës, të dytën 20 dhe të tretën 21. Në total, në nivelin e ulët të mësimi, 302 është numri i nxënësve që e kanë përsëritur klasën. Kush ka përgjegjësi këtu dhe a do të merrni veprime?

Dafina Gashi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Fillimisht, e përgëzoj drejtorin për këtë raport kaq të detajuar. Po ndalem te gjimnazet: totali i nxënësve është 971, ndërsa, te tabela e paraqitur 16 e kanë përsëritur vitin, ndërsa 92 nxënës janë të panotuar. Çfarë masash janë ndërmarrë për të siguruar vlerësimin e këtyre nxënësve dhe qfarë statusi aktual e kanë ata?

Defrim Kafexhiu: M'u kujtua që në seancën e kaluar e kam për pyetje për përzgjedhjen e drejtorit të shkollës “Isa Boletini”, nuk kam marrë përgjigje, sepse kryetari nuk ka qenë këtu. E çmoj sinqeritetin e drejtorit në përgjigjet e tij, në kërkesat dhe vërejtjet tona. Një gjë duhet ta kuptojmë, të gjithë jemi këtu për një qëllim, që sistemi i arsimit në komunën tonë të jetë sa më i mirëfillt. Kandidati nuk e ka kaluar testin me shkrim, por pas një muaji është emëruar drejtor me kohë të caktuar. Nëse ka mundësi, kryetari të na sqarojë këtë situatë.

Kryesuesi: Këtë pyetje që gati e harrove ti, duhet ta bësh në pikën “pyetje dhe përgjigje”. Mos t'i përziejmë pikët. Fjalën e ka kryetari kryetari.

Kryetari: Faleminderit, kryesues! Nuk është përzierje, sepse në mbledhjen e kaluar kam qenë i angazhuar në takim me kryetarët e komunave dhe me ambasadën gjermane. Është në kompetencë të kryetarit që ta nxjerr ushtruesin e detyrës për një periudhë 6-mujore, me të drejtë vazhdimi edhe për 6 muaj të tjera. Meqenëse është shkollë e madhe, e kam marrë këtë masë për ushtrues detyre. Shpresoj që brenda afatit optimal do ta shpallim konkursin për drejtor ose drejtoreshë, për shkollën “Isa Boletini” dhe për “Nisimi Elshani”.

Muhamet Morina: Lirigzoni pyetje rreth numrit të vogël të fëmijëve regjistruar në çerdhe. Nuk duhet të shqetësohemi në këtë pikë, sepse është vetëm afati i parë dhe kërkesat për regjistrim në afatin e dytë janë të mëdha. Në Rahovec, veçse janë tejkaluar pritshmëritë. Lirigzoni poashtu pyet rreth cilësisë në testin e maturës. Është

shqetësues në nivel vendi, edhe pse kjo nuk është justifikim që edhe ne të dalim jo mirë. Plani i DKA-së është mësim plotësues për nxënësit që kanë talent në profile të ndryshme. Qazim Cana pyeti rreth organizimit të mësimi formal në IAAP: Do të përpiqemi ta organizojmë mësimin joformal, edhe pse kërkesa ka ardhur me vonesë. Zana pyeti për relacionin “mungesa-suksesi”. Është shumë e vërtetë ajo që e tha asambleistja Zanë. Do të përpiqemi të bashkëpunojmë me prindërit, pedagogët, mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e shkollave, që ta kryejnë punën e tyre pak më me përpikëri. Vlorë, në disa shkolla kemi asistentë të angazhuar për fëmijët me nevoja të veçanta. Dikush pyeti për sistematizimin e vendeve të punës: ka mësimdhënëse që janë duke punuar, por që nuk janë profesionistë të fushës. Prandaj, sipas ligjit duhet të shpallim konkurs për ta, si dhe ka prej tyre që dalin në pension. (Probleme me zërim dhe ndërprerje të vazhdueshme*). Zonja Hazbije, në klasë të para planifikohen të regjistrohet 40 paralele, ndërsa nga parafillorja kanë ardhur 521 nxënës. Defrim, pajtohet me ju rreth asaj që nuk është duke funksionuar transferi i nxënësit, si sanksion për mungesat e bëra. Është problematikë, e cila me udhëzim administrative nuk është në dorën e DKA-së, por të ministrisë. Dafinë, po, numri i nxënësve të panotuar është i madh. Më ka bërë përshtypje që në një shkollë të mesme janë 40 nxënës të panotuar. Jam interesuar për këtë gjë dhe fjala është për nxënësit të cilët nuk i kanë vijuar mësimet. Bujari, rreth riparimit të nyjeve sanitare: Në Celinë ka filluar riparimi i nyjeve sanitare, sepse shkolla me të vërtetë ka qenë në gjendje jo të mirë. Shkollën e kam vizituar dhe punët janë duke shkuar mirë. Drejtorët parapakisht duhet të bëjnë kërkesë në DKA, ndërsa ne, bashkë me operatorin dhe inxhinierët komunalë e incizojmë gjendjen faktike dhe pastaj e vlerësojmë se çfarë pune duhet të kryhet.

Vlora Vuçiterna – Çmega: Meqenëse jemi te nyjet sanitare, a ka bërë kërkesë drejtori i shkollës “Gëzim Hamza – Piktori” për rregullimin e nyjeve sanitare, meqenëse e dimë që ajo shkollë ka nevojë për intervenim?

Muhamet Morina: Jam interesuar për këtë çështje, kam shkuar në vizitë dhe është shqetësuese gjendja. Në atë shkollë nuk ka dy vjet që është bërë rinovimi i nyjeve sanitare dhe tani gjendja është e mjerueshme. I kemi ekipet në terren, të cilat janë duke punuar dhe këtë operator nuk do ta lëmë të lirë, derisa t’ju plotësojmë kushtet nxënësve tanë.

Jusuf Dërmala: Drejtor, a keni menduar ndonjëherë për ndonjë platformë komunale, që do të kishte ndikuar në rritjen e cilësisë dhe përgjegjësisë të mësimdhënësve, që qytetari të ketë çasje direkte në sistem për ndonjë sugjerim, apo ankesë? Tjetra, disa prej aktiviteteve që po i shoh këtu, më duken vetëm sipërfaqësore. Mirë është disa prej aktiviteteve të tilla të reduktohen. Pastaj, pse duhet të jetë “dita e shkollës” ditë pushimi? Nuk është e logjikshme kjo qasje, e cila duhet të ndryshohet. Thelbësor është komunikimi prind-mësimdhënëse.

Muhamet Morina: Faleminderit! Platformën që e kërkon është vërtetë e mirë dhe mendoj që do t’i ndihmonte edhe zvogëlimin të mungesave të nxënësve. Në shkollat tona ka shumë nxënës të zotë të informatikës, të cilët mund të kryejnë shërbime të tilla. Staf i ynë i arsimit gjithashtu mund të bëjë punë të mirë. Duke u bazuar në mundësitë tona buxhetore, mund ta planifikojmë një projekt të tillë.

12. Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të QMF-së në Fortesë:

Afrim Oruqi: Siç e thash edhe në fillim të mbledhjes, bëhet fjalë për një parcelë komunale në ZK Fortesë. Parcela ka sipërfaqe prej 1 ha 31 ari e 111m² dhe prej kësaj parcele po kërkojmë të marrim vendim për caktim të lokacionit prej 18 ari, për ndërtimin e QMF-së. Gjithashtu, përmes këtij vendimi kërkoj nga ju që në këtë parcelë të përfshihet edhe rruga lokale, andaj ta ndajmë parcelën, t’ia japim një numër sipërfaqes dhe të caktohet lokacion për ndërtimin e QMF-së dhe të fillojmë me procedura të tjera.

Kryesuesi: Në fillim të mbledhjes drejtori dha sqarime, meqenëse për këtë pikë momentalisht nuk kemi material, por ekziston memorandumi ndërmjet kryetarit dhe ministrisë.

Lirigzon Kastrati: Natyrisht që e përkrahim një vendim të tillë. Në mandatin e kaluar kur kam qenë anëtarë i Komiteti për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale i kemi vizituar të gjitha QMF-të dhe AMF-të. Gjatë vizitave, në

Fortesë bashkë me kolegen Vlorë, e kemi parë që gjendje është jo e mirë dhe sfafin i pamundësohet puna për shkak të lagështisë. Si planifikohet projekti i ri?

Kryetari: Në projektin e ri merr pjesë Komuna e Rahovecit, bashkë me inxhinierët e ministrisë. Objekti i ri do të ngritët mbi nivelin e tokës dhe ashtu që nuk do të ketë më lagështi. Intervenimet kanë qenë të kota, sepse me pak reshje aty është bërë lagështia.

Kryesuesi: Faleminderit, kryetar! Dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë po e vendosi pikën në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenime?... Me 20 vota “për” miratohet ky vendim.

13. Pyetjet, përgjigjet dhe diskutimet e kuvendarëve:

Vlora Vuçiterna – Çmega: Fillimisht, a jemi në transmetim apo jo?... I përgëzoj dhe i falënderoj nënat, me iniciativë të cilave në çerdhen “Tulipanët” janë vendosur lodrat në atë çerdhe. Nuk e di nëse kjo është bërë me participim të komunës apo vetëm me angazhimin e tyre, por sidoqoftë është një nismë që më ka pëlqyer shumë. Po rikthehem edhe një herë te një çështje që e kam ngritur vazhdimisht në kuvend në mandatin e kaluar. Rahoveci ka nevojë urgjente për një hapësirë moderne recreative për fëmijë. Një park i mirëfillt nuk është vetëm investim për fëmijët tanë, por edhe për ekonominë lokale. Sa familje detyrohet çdo fundjav për të shkuar nëpër komuna të tjera, që fëmijëve të tyre t’i ofrojnë rekreacion e argëtim, pse paratë të mos mbeten në Rahovec dhe të përfitojnë bizneset tona. Fatkeqësisht, kemi pak mundësi që një fundjavë ta kalojmë në një hapësirë të përshtatshme dhe të sigurtë. Shpresoj që kjo iniciativë e bukur e nënave të jetë shtytëse edhe për institucionet, që më në fund të trajtohet seriozisht nevoja për një park rekreativ dhe dinjitoz për fëmijët e Rahovecit. Te shëndetësia: Së fundi, e kam parë një konkurs që është shpallur për disa pozita. Sipas asaj çka flitet në QKMF, konkurset janë hapur pikërisht për anëtarët e partisë suaj, të cilët punojnë aty dhe tani do t’i bëni edhe udhëheqës. Një pozitë është e re, zëvendës drejtor dhe aty dihet kush do të pranohet. Nuk po i përmendi me emra, meqenëse tani po eskalon debati. Një pozitë tjetër, “kryeinfermier i vaksinimit” edhe këtu flitet se do të pranohet ish-kandidatja juaj për asamble. Pozitën “kryeinfermier i edukimit të vazhdueshëm” edhe aty është njeriu i afërt i kryetarit. Janë edhe 3-4 pozita që janë anëtarë të partisë së juaj. A nuk shihni ju njerëz të tjetër të aftë për udhëheqje në QKMF, apo pozitat po i rezervoni vetëm për njerëz të afërt me pushtet. Më besoni që nuk jeni duke dalur mirë. Jo rrallëherë, ajo çka është përfolur ka dalur ashtu, bile jeni dëshmitarë edhe vet. Sa herë që kam postuar në rrjete sociale për ndonjë konkurs ku është përfolur se kush do të pranohet, për qudi ka dalur ashtu. Shpresoj që nuk do të ndodhë kështu, jo që kam diçka personale me këta persona, por mendoj që në QKMF në Rahovec ka edhe infermiere të tjerë me përvojë shumëvjeçare, të cilët kanë aftësi për t’i udhëhequr këto pozita. Një çështje tjetër te shëndetësia: Meqenëse AMF-ja në Lagjen e Epërme aktualisht është jashtë funksionit dhe objekti e dimë që është relativisht në gjendje shumë të mirë. A e keni në plan që këtë objekt ta shëndërroni për një destinim tjetër në përputhje me nevojat e qytetarëve dhe me kriteret ligjorë. Nëse veç e lejon ligji, një çerdhe apo diçka tjetër.

Hazbije Shala: Dua ta ngris një çështje për fshatin Retijë. Gjatë vizitave tona nëpër fshat, kemi qenë dëshmitarë të gjendjes jo të mirë të rrugës, e cila të çon te varrezat e dëshmorëve të Lisi i Dërvishit. Kjo rrugë është në gjendje të papërshtatshme për qarkullim dhe do të ishte mirë që komuna të intervejojë me kubëza, për hir të atyre që e kanë dhënë gjakun dhe për familjarët e tyre.

Defrim Kafexhiu: Dua të lidhem me konsultimin publik për Hartën Zonale. Disa qytetarë janë revoltuar pse nuk e kanë parë asnjë asambleist të pranishëm aty. Kushdo prej qytetarëve që kanë marrë pjesë, është mirë të kontribuojnë. Por, anëtarët e kuvendit merren vazhdimisht me këto punë dhe nuk do të thotë që është obligim pjesëmarrja në konsultime publike. I ftoj qytetarët që kanë reaguar që të vazhdojnë kontributin e tyre, me komente

dhe me sugjerime. Njëkohësisht, e ftoj ekzekutivin e komunës që t'i merr parasysht të gjitha kërkesat e qytetarëve, grupeve të interesit dhe njerëzve profesionalë rreth draftit të Hartës Zonale. Nuk kam arritur ta shqyrtojë shumë personalisht, po janë evidente dhe tendencioze disa prej gjërave që lidhen me njerëzit, me pronat, me anëtarët e ekzekutivit, ose më mirë me njerëzit e pushtetit. Ju ftoj që kjo Hartë Zonale të përpilohet në formën më të mirë të mundshme dhe kur të vjen në kuvend për miratim, të jetë në shërbim të qytetarëve dhe t'ua lehtësojë jetën atyre dhe zhvillimin komunës. Një problematikë tjetër që dua ta diskutoj: Kryetar, është mirë që je tani i pranishëm, sepse kohëve të fundit je duke munguar më shpesh. Jo që seanca e kuvendit nuk mund të mbahet pa kryetarin, por anëtarët e kuvendit dhe qytetarët e mbajnë përgjegjësi kryetarin për vendimet që i merr. Të ftoj që në mbledhjen e ardhshme të KKSB-së, si temë diskutimi të jetë puna e trotinetëve elektrikë ose merre një urdhëresë (nuk e di se si implementohet), por është mirë që të ndalohet përdorimi i trotineteve elektrikë deri në moshën 15 vjeçare, ose për ata që nuk kanë ende letërnjoftim. Nëse veç është e ndaluar, nga komandanti i policisë të kërkohet që ligji të zbatohet, sepse nuk është duke u zbatuar. Para se të ndodhë më e keqja, është mirë që të marrim masa në këtë pjesë. Nuk mund të jetë i vetëdijshëm një fëmijë 10 vjeçar ta ngas në rrugë një trotinet elektrik, sepse përveç që e rrezikon veten, i rrezikon edhe pjesëmarrësit e tjerë në komunikacion.

Behlul Krasniqi: Një pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike: Banorët e një lagje në fshatin Senoc kanë probleme me kanalizim. Kur pritet intervenimi, sepse janë bërë mbi 5 muaj që janë në gjendje të njëjtë? Një pyetje për drejtorin e Arsimit: Sa i përket shkollës në fshatin Senoc, gjendja është ajo që edhe drejtori e din. Kush pritet intervenimi në atë shkollë, si dhe intervenimi në kanalizim që është brenda shkollës?

Yllka Shehu: Rruga "Bylbyl Shehu" që ndodhet në Bërnjakë. Kjo rrugë ka vite që ka mbetur gjysmë e asfaltuar dhe më intereson të di, pse ndodh që një punë të fillojë dhe me vite të tëra të mbetet gjysmë e përfunduar? Bëhet fjalë për një rrugë që frekuentohet prej vreshtarëve, duke e ditur që tani ka filluar edhe koha e punimit të vreshtave dhe nëse punimet do të përfundonin do të ishte një ndihmë e madhe për ta. A ka ndonjë plan konkret?

Kryetari: Përsëritet për kryesuesin, drejtorët, asambleistët, mediat. T'ju them të drejtën, herën e kaluar kam qenë në Maltë dhe nuk kam mundur të jem prezent në seancë. E dyta, sot kam qenë në një takim të rëndësishëm që është caktuar para një muaji, me zyrtarin e BE-së, përfaqësuesin e ambasadës gjermane, për një projekt rreth menaxhimit të mbeturinave. Projekti që parashihet është 100 milionë. Po ju jap një lajm të mirë. Pas 20 viteve, trafoja në lagjen "Vëllezërit Frashëri" është në funksion. Janë shumë e shumë arsye se pse është vonuar, por më në fund përfundoi dhe është në funksion. Sa i përket riparimeve të shkollave, janë gjëra që janë cilësuar edhe në raportin e ZKA-së. Fatkeqësisht, nuk ka komunë në Republikën e Kosovës që e ka raportin e pamodifikuar, pikërisht për shkak të keqklasifikimeve. Kjo është keq, sepse e penalizon komunën në projekte investive. Sa i përket QKMF-së: nuk mund t'i mbajmë vazhdimisht me ushtrues detyre, sepse kemi marrë vërejtje serioze nga Ministria e Shëndetësisë. Kushdo që pranohet, do të pranohet në bazë të kriterëve, kualifikimeve dhe të vlerësimeve në test me shkrim. QKMF-ja e ka një statut që duhet t'i përmbahemi. Pra, nuk bëhet fjalë për vende të reja, por për "paketim" të personelit shëndetësor në përputhje të statutit. E di që ka edhe rekomandime për mbyllje të shkollave, por ne bazohemi te plani i Ministrisë së Arsimit, sepse nuk jemi këtu për t'i mbyllur shkollat. Te ndërrimi i destinacionit të objekteve, ne mund të bëjmë diçka në lidhje me këtë çështje, ashtu siç kemi bërë me shtëpinë e pleqve, apo edhe me shtëpinë e shëndetit në Zoqisht, me të vetmin qëllim: objektet mos t'i lëmë jashtë funksionit, por t'i ridestinojmë në përputhje me nevojat dhe kërkesat e komunitetit. Te trotinetat: kjo është çështje e rregulluar me ligjet e trafikut. Sigurisht, në takimin e radhës të KKSB-së do të diskutojmë.

Nehar Shala: E kuptoj krizën financiare në të cilën po kalon komuna, por unë e kam obligim ta bëj si kërkesë: Në Krushë të Madhe, a pritët të interenohet në rrugën "Hysni Duraku" që të çon në drejtim të Drinit të Bardhë? Njëjtë edhe rruga "Avdyl Zeqiri" që është poshtë rrugës kryesore ku ka qenë rruga "Arif Shala". Kjo ka qenë premtim i kryetarit të komunës, në fushatën e zgjedhjeve të kaluara lokale.

Kryetari: 684.000 euro nga Granti i Performancës për 2024, ende nuk i kemi marrë edhe pse sot është data 23 korrik dhe gjysma e parave janë për atë projekt për të cilin fole dhe do të bëhet një zgjidhje shumë e mirë. Marrëveshjen e memorandumit e kam nënshkruar me ministrin në detyrë, Elbert Krasniqi. Projekti është i gatshëm dhe potencialisht sa më shpejtë duhet të fillojë me para të grantit 2024, që Komuna e Rahovecit i ka fituar.

Kryesuesi: A ka dikush tjetër?... Nëse jo, atëherë me një urim të fundit për Defrimin për përfundimin e punimeve të trafos, po e përfundojmë mbledhjen e shtatë të rregullt. Shihemi në seancën e radhës.

Procesmbajtësi:


Albion Krasniqi



KRYESUESI


Fatmir Iska